

VENDIM
Nr. 56, datë 28.10.2019

PËR LICENCIMIN PËR HERË TË PARË TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME KËLCYRË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr.958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit ‘Për licencimin për herë të parë të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Këlcyre sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Këlcyre (UK Këlcyre), me shkresën nr. 26 prot. datë 14.11.2017, me lëndë “Kërkesë për licencim”, shkresën nr. 50 prot., datë 10.8.2018 “Shkresë për plotësim dokumentacioni”, shkresën nr. 27 prot., datë 31.7.2019 “Shkresë për plotësim dokumentacioni”, shkresën nr. 30 prot., datë 30.9.2019 “Shkresë për plotësim dokumentacioni”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për herë të parë.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për herë të parë për UK Këlcyre në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezultoi:

a) Shoqëria UK Këlcyre ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 5 754 banorë në Bashkinë Këlcyre si më poshtë:

Zona e shërbimit me furnizim me ujë nga shoqëria UK Këlcyre:

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Këlcyre	Popullsia në juridiksion	Popullsia e shërbyer
1	Këlcyre	5 089	2 516
2	Deshnicë	2 600	1 204
3	Sukë+Ballaban	4 700	2 034
	TOTALI	12 389 banorë	5 754 banorë

b) Drejtuese teknike e shoqërisë, znj. Aldisa Durdaj, mban titullin master profesional në “Inxhinieri mjedisi”, datë 18.10.2016, pranë Universitetit Politeknik Tiranë.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Këlcyre, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi teknike-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Këlcyrë, rekomandon:

- Shoqëria UK Këlcyrë duhet të aplikojë pranë ERRU-së për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë;

- Shoqëria UK Këlcyrë duhet të punojë në drejtim të zgjerimit të zonës së shërbimit në mënyrë që të gjithë banorët e Bashkisë Këlcyrë të marrin shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura nga kjo shoqëri me cilësi dhe brenda standardeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Këlcyrë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Këlcyrë sh.a., me NUIS K49225204A në kategoritë:

a) kategoria A – për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Këlcyrë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor – Elidon Beqiri;

b) drejtuese teknike – Aldisa Durdaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Këlcyrë sh.a., është:

Bashkia Këlcyrë: Njësia Administrative Këlcyrë (pjesërisht);

Deshnicë (pjesërisht);

Sukë + Ballaban (pjesërisht).

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Këlcyrë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Këlcyrë sh.a., për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani